



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr. 2358 date, datë 27.09.2013

Për

“Shqyrtimin e ankimit administrativ të Altelecom sh.a. për modifikimin e aktit administrativ: Vendim nr. 2338, datë 31.7.2013, “Për përcaktimin e sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese””.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Znj. Alketa	Mukavelati	Kryetare
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Znj. Elkeda	Domi	Anëtare
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtare

dhe sekretare Znj. Mirela Xhelaj, në mbledhjen e datës 27.09.2013, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”), ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Shqyrtim i ankimit administrativ të Altelecom sh.a. për modifikimin e aktit administrativ: Vendim nr. 2338, datë 31.7.2013, “Për përcaktimin e sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese”

BAZA LIGJORE:

1. Neni 8, neni 31 e në vijim, nenit 52, pika 1 e nenit 114, pika 1 e nenit 115, nenet 107 dhe 120/1 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**Ligji nr. 9918**);

2. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (K.Pr.A);
3. “Rregullore për analizën e tregut”, miratuar me vendimin nr. 747, datë 17.07.2009, te Keshillit Drejtues të AKEP (Rregullorja).
4. Pika 17, e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP” (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim nr. 170, datë 24.04.2004 të Këshillit Drejtues të AKEP, e ndryshuar.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr. 5274Prot., datë 2.9.2013 (nr. 1496Prot. i AKEP, datë 4.9.2013), i drejtohet AKEP me kërkesë ankimore brenda afatit të percaktuar në nenin 140 të Kodit Procedurave Administrative në lidhje me Vendimin e miratuar nga AKEP nr. 2338, datë 31.7.2013, për “Për përcaktimin e sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese”
2. Vendim Nr. 2336 date 30.07.2013, Për “Miratimin e Dokumentit: Analizë e tregut telefonisë fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokumenti Perfundimtar”,
3. Vendim nr. 2338, datë 31.7.2013, “Për përcaktimin e sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese”
4. Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (*Relacioni*);
si dhe duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N :

- 1) Albtelecom sh.a. me anë të shkresës nr. 5274Prot., datë 2.9.2013 (nr. 1496Prot. i AKEP, datë 4.9.2013), i drejtohet AKEP me kërkesë ankimore brenda afatit të percaktuar në nenin 140 të Kodit Procedurave Administrative në lidhje me Vendimin e miratuar nga AKEP nr. 2338, datë 31.7.2013, për “Për përcaktimin e sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese” me qëllim ndryshimin/modifikimin e vendimit të AKEP për vendosjen e statusit FNT për operatorët alternativë edhe në tregun me shumicë të origjinimit të thirrjeve në rrjetin telefonik publik të ofruara nga vendndodhje fikse.
- 2) Albtelecom me anë të këtij ankimi administrativ shpjegon se AKEP, në analizën e tregut fiks ka identifikuar si operator aktivë që ofrojnë shërbimin e origjinimit të thirrjeve zanore në rrjetet fikse të telefonisë: Albtelecom sh.a., Operatorët Alternativë të rrjeteve të telefonisë fikse dhe AMC fiks. Ndër faktorët themelorë të marrë në këtë analizë janë: pjesët e tregut, fuqia kundërvepruese e blerësve, si dhe vlerësimi i

konkurrencës potenciale në treg. Kriteri i *pjesës së tregut* është i vetmi faktor përcaktues për gjetjen e Albtelecom me FNT në tregun e origjinimit. Albtelecom shpjegon se, sic parashikohet edhe në kuarin rregullator të BE për shërbimet e komunikimeve elektronike, në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 (indryshuar) neni 33 pika 2, si dhe “*Rregullores për analizën e tregut*”, kriteri i pjesës së tregut nuk mund të merret si i vetëm për shpalljen me FNT. Albtelecom përmend se edhe operatorët alternative dhe AMC fiks ofrojnë origjinim thirrjesh, janë të integruar vertikalisht si dhe operatorët e kartave me parapagim nuk kanë pasur asnjë pengese juridkike apo ekonomike për zhvillimin e tyre duke përdorur rrjetin e Albtelecom. Gjithashtu Albtelecom përmend se ka pasur vështirësi në përdorimin e kartave me parapagim Albblue në rrjetet e operatorëve alternative.

- 3) Sa më lart Albtelecom, bazuar edhe në nenin 7 pika 3 gërma ‘ë’, ku parashikohet se AKEP nuk duhet të diskriminojë në trajtimin e sipërmarrësve të shërbimeve të komunikimeve elektronike, kërkon:

1. Ndryshimin/modifikimin e pikës 1 të vendimit nr. 2338, si më poshtë:

Bazuar në dokumentin “*Analizë e tregut të telefonise fikse: tregjet me pakicë dhe tregjet me shumicë shumicë të terminimit, tranzitimit dhe origjinimit – Dokumenti përfundimtar* – “, miratuar me VKD nr. 2336 datë 30.7.2013, të përcaktojë sipërmarrësit sipas listës së Aneksit 1, sipërmarrës me FNT në tregjet e mëposhtme:

1.1 Tregu me shumicë i origjinimit të thirrjeve në rrjetin telefonik publik të ofruara nga vendndodhje fikse.

1.2 Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të sipërmarrësit të ofruara nga vendndodhje fikse.

Zona gjeografike e tregut përkatës për sipërmarrësin e përcaktuar me FNT është zona e mbulimit me shërbim publik telefonik fiks nga rrjeti i sipërmarrësit.

2. Modifikimin e pikës 2 të vendimit nr. 2338, si më poshtë:

Sipërmarrësi i përcaktuar me FNT, në tregjet e terminimit dhe origjinimit është i detyruar të zbatojë detyrimet përkatëse si më poshtë, por pa u kufizuar:

- Detyrimi i mosdiskriminimit (neni 39);
- Detyrimi i transparencës (neni 40);
- Detyrimi për ndarjen e llogarive (neni 41);
- Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (neni 42);
- Detyrimi për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (neni 45);

2.1 Detyrimi i mosdiskriminimit nënkupton:

Sipërmarrësi i përcaktuar me FNT, të zbatojë kushte të njëjta në rrethana të njëjta ndaj sipërmarrësve të tjerë që ofrojnë shërbime ekuivalente, si dhe t’u ofrojë

sipërmarrësve të tjerë shërbime dhe informacion në kushte të njëjta dhe me cilësi të njëjtë, sikundër ai i ofron për shërbimet e veta, filialet apo partnerë të tij;

Sipërmarrësi i përcaktuar me FNT, të përditësojë ORI-n, për ta përshtatur me përcaktimet e këtij vendimi dhe me ndryshimet dhe nevojat e tregut, brenda 45 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

Sipërmarrësi i përcaktuar me FNT, të publikojë marrëveshje të Nivelit të Shërbimit si dhe Tregues kryesorë të përfomancës për interkoneksionin sipas përcaktimeve të “Rregullores për akses dhe interkoneksion”.

2.2 Detyrimi i transparencës:

ORI e përditësuar nga sipërmarrësi i përcaktuar me FNT duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm, të nevojshëm për interkoneksion me sipërmarrësin:

- a) Specifikimet teknike;
- b) Karakteristikat e rrjetit;
- c) Termat dhe kushtet për ofrimin dhe përdorimin;
- ç) Tarifat përfshirë zbritjet e mundshme.

2.3 Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit:

Sipërmarrësi i përcaktuar me FNT për terminimin dhe origjinimin e thirrjeve në rrjetin e tij duhet:

- a. të mos anulojë aksesin në facilitet kur e ka dhënë atë;
- b. të negociojë me dëshirën e mirë dhe me mirëbesim me subjektet, që kërkojnë akses;
- c. të ofrojë akses të hapur në ndërfaqet teknike, protokollet ose teknologjitë e tjera të rëndësishme, të domosdoshme për ndërveprimin e shërbimeve ose për shërbimet e rrjetit virtual;
- d. të ofrojë bashkëvendosje ose forma të tjera të përdorimit të përbashkët, përfshirë ndërtesat, tubacionet kabllore ose shtyllat, kullat;
- e. të krijojë kushtet e nevojshme për të siguruar ndërveprimin e shërbimeve pikë fundore – pikë fundore, duke përfshirë facilitetet për shërbimet e rrjetit inteligjent;
- f. të ofrojë akses në sistemet mbështetëse funksionale ose sistemet e ngjashme informatike të nevojshme për të siguruar konkurrencë të ndershme në ofrimin e shërbimeve;
- g. të interkonektojë rrjetet ose facilitetet e rrjetit.

2.4 Detyrimet për mbajtje të llogarive të ndara, kontroll të tarifave dhe orientim në kosto:

Tarifat e shërbimeve të terminimit dhe origjinimit të thirrjeve dhe shërbimeve të interkoneksionit të lidhura me këto shërbime në rrjetin publik telefonik fikse të sipërmarrësit me FNT janë objekt kontrolli dhe rregullimi nga AKEP.

Tarifat e shërbimeve të terminimit dhe origjinimit të thirrjeve duhet të jenë të orientuara drejt kostos duke marrë në konsideratë investimin e bërë nga sipërmarrësi, përfshirë një normë të arsyeshme fitimi mbi kapitalin e punësuar dhe riskun.

Tarifat e shërbimeve me shumicë të interkoneksionit të jenë sipas vlerave dhe afateve të dhëna në tabelën e mëposhtme:

Vlerat maksimale të tarifave të terminimit dhe origjinimit në rrjetin e sipërmarrësit me FNT 2014 – deri në një vendim tjetër të AKEP

	Aktuale – 31.12.2013	Faza I 1.1.2014- 31.8.2014	Faza II 1.9.2014 deri në një vendim tjetër të AKEP
Terminim – origjinim (tarifa lekë/min)			
Lokal	1.5-1.95	1.50	1.34
Mesatare- njëfish/dyfish	2.5-3.25/3.5	2.42	1.77
Tarifë fikse për thirrje (lekë/thirrje)	0.83	0.53	0.38

Shënim: tarifat janë pa TVSH

Zbatimi i detyrimit të ndarjes së llogarive dhe mbajtjes së llogarive (nenet 41 dhe 45) dhe zbatimi i detyrimit të orientimit në kosto të tarifave të interkoneksionit (neni 59), nga sipërmarrësit me FNT, do të kryhet në bazë të parashikimeve të mëvonshme të AKEP.

- 4) AKEP pasi ka shqyrtuar sa më lart ka parashtruar Albtelecom, arsyeton se:
- a. AKEP nuk ka përdorur vetëm kriterin e pjesës së tregut në përcaktimin me FNT të Albtelecom dhe mospërcaktimin e operatorëve të tjerë me FNT. Megjithatë, pjesa e tregut është pikënisja e përcaktimit me FNT, dhe përdorimi i kriterëve të tjera është më shumë i nevojshëm në rastet kur pjesa e tregut është e madhe, ç'ka mund të rezultojë në mungesë FNT, ndërkohë kur 78 operatorë së bashku kanë 11% pjesë tregu, është e vështirë të argumentohet se secili prej tyre ka FNT në treg.
 - b. Në lidhje me problemet e pamundësisë së përdorimit të kartës me parapagim Alablue nga rrjetet e operatorëve të tjerë fikse, Albtelecom mund t'a shtrojë

problemet si mosmarrëveshje. AKEP gjykon se ky problem i Albtelecom mund të ekzistojë edhe me ofrues të tjerë të kartave me parapagim, megjithatë fakti se operatorë të tjerë nuk kanë sjellë problem të tilla për zgjidhje në AKEP tregon se këta operatorë janë të interesuar për përdorimin e tyre kryesisht nga pajtimtarët e Albtelecom si operatori dominant në këtë treg (me mbi 90% pjesë tregu). Megjithatë, AKEP vlerëson se kjo problematikë dhe të tjera të lidhura me të mund të trajtohen në mënyrë specifike nga AKEP, duke vendosur detyrime për të gjithë operatorët (pavarësisht kanë ose jo status me FNT) të ofrojnë akses për shërbime të caktuara në interes të konsumatorëve dhe konkurrencës në treg.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 146, gërma a), të K.Pr.A, si dhe pikën 17, të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Lënien në fuqi të aktit administrativ Vendim i Këshillit Drejtues nr. 2338, datë 31.7.2013 dhe rrëzimin e ankimit administrativ të Albtelecom sh.a. nr. 5274Prot., datë 2.9.2013 për modifikimin Vendimit nr. 2338, datë 31.7.2013, “*Për përcaktimin e sipërmarrësve me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese*”.
2. Të njoftohet Albtelecom sh.a. për zbatimin e këtij Vendimi;
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R E

Alketa MUKAVELATI

ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Elkeda DOMI**
4. **Zamira NURÇE**